

## PASQYRAT FINANCIARE

( Mbeshtetur ne Ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", te ndryshuar, dhe SNFR )

### Te dhena identifikuese

Emri..... TURGUT OZAL EDU.SHA

NIPT ... .. K 12125004 O

Adresa Rr. "Pavaresia", Autostrada  
Tirane - Durres, Km.1 Tirane

Data e krijimit ..... 21.05.2001

Nr. I Regjistrit Tregtar

Objekti i Veprimtarise

Arsim

### Te dhena te tjera

Pasqyrat financiare

Monedha ..... Leke

Rrumbullakimi .....

Periudha Kontabel

Nga 01.01.2016 deri 31.12.2016

Data e plotesimit te pasqyrave financiare

20/03/2017



TURGUT ÖZAL EDU. SH.A.  
BILANCI

01.01.2016 - 31.12.2016

	Shenimet	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktive materiale afat-gjata	4	2,271,361,991	2,387,858,745
Aktive jo material afat-gjata	5	4,838,267	5,692,079
Fitim i shtyre nga rivleresimi		-	62,919,414
<b>Totali</b>		<b>2,276,200,258</b>	<b>2,456,470,238</b>
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Inventar	6	13,405,028	13,143,385
Llogari te arkëtueshme	7	67,281,595	58,347,076
Tatim fitimi i arkëtueshëm	22	16,470,974	31,461,654
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	8	23,121,426	52,730,385
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>120,279,024</b>	<b>155,682,500</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>2,396,479,282</b>	<b>2,612,152,738</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali aksionar	9	1,133,700,000	1,133,700,000
Rezerva të tjera	9	52,664,836	52,003,276
Fitime të pashpërndara	9	127,313,513	13,231,196
<b>Totali</b>		<b>1,313,678,349</b>	<b>1,198,934,472</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		-	-
Hua afatgjatë	10	796,196,424	803,893,776
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>796,196,424</b>	<b>803,893,776</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtër	10	145,456,028	331,359,447
Llogari të pagueshme	11	76,474,285	82,184,641
Të pagueshme të tjera	12	64,674,195	195,780,403
		-	-
		-	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>286,604,508</b>	<b>609,324,490</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>			
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>2,396,479,282</b>	<b>2,612,152,738</b>

HARTUESI

*Iva Hafizi*



DREJTORI

*Mustafë Ustner*





**TURGUT ÖZAL EDU. SH.A.**  
**BILANCI**      **01.01.2016 - 31.12.2016**

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndare	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2015</b>	1,133,700,000	43,159,717	173,796,905	1,350,656,622
Fitimi I vitit	0	0	13,231,196	13,231,196
Të ardhura te tjera gjithëpërfshirëse	0	0	0	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	<b>13,231,196</b>	<b>13,231,196</b>
Transferimi I fitmit të pashpërndarë në rezerva të tjera	-	8,843,559	-8,843,559	0
Shpërndarja e dividendit	0		-164,953,346	<b>-164,953,346</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,133,700,000</b>	<b>52,003,276</b>	<b>13,231,196</b>	<b>1,198,934,472</b>
Fitimi I vitit	-	-	127,313,513	127,313,513
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	<b>127,313,513</b>	<b>127,313,513</b>
Transferimi I fitmit të pashpërndarë në rezerva të tjera	-	661,561	-661,561	-
Dividenti i deklaruar	-	-	-12,569,635	-12,569,635
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,133,700,000</b>	<b>52,664,837</b>	<b>127,313,513</b>	<b>1,313,678,349</b>

HARTUESI

*Ilir Hoxha*



DREJTORI

*Marta Ustiner*



TURGUT ÖZAL EDU. SH.A.

B I L A N C I

01.01.2016 - 31.12.2016

	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
Fitimi para tatimit	150,259,625	16,710,409
<b>Rregullime për:</b>		
Shpenzime amortizimi	155,937,046	164,484,112
Shpenzime interesi	52,683,104	60,089,718
Humbja e pa realizuar nga kursi i këmbimit	62,919,414	75,076,374
<b>Fitimi në aktivitetin operativ përpara ndryshimeve në kapitalin punues:</b>	<b>421,799,190</b>	<b>316,360,613</b>
Rritje ne llogaritë e arkëtueshme	-8,934,520	-44,048,483
Fitim/ (humbje) ne inventar	-261,643	-3,631,043
Rritje ne llogaritë e pagueshme	-5,710,355	25,886,683
Rritje e detyrimeve të tjera	-131,106,208	179,852,167
Interesi i paguar	-52,683,104	-60,089,718
Tatimi i paguar mbi fitimin	-7,955,433	-20,501,102
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto e përdorur gjatë veprimtarisë së shfrytëzimit</b>	<b>215,147,926</b>	<b>393,829,117</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimit</b>		
Blerje të aktiveve fikse material	-38,586,481	-76,047,215
Shitje të aktiveve fikse material	0	
Blerje të aktiveve jomateriale		
Shitje të aktiveve jomateriale	0	
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto e përdorur në veprimtaritë e investimit</b>	<b>-38,586,481</b>	<b>-76,047,215</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet financiare</b>		
Rrënie e kredive afatgjata	-193,600,771	-151,699,386
Dividentët e paguar	-12,569,635	-164,953,346
<b>Mjetet monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financiare</b>	<b>-206,170,406</b>	<b>-316,652,732</b>
<b>Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre</b>	<b>-29,608,960</b>	<b>1,129,170</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të periudhës</b>	<b>52,730,385</b>	<b>51,601,215</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	<b>23,121,425</b>	<b>52,730,385</b>

HARTUESI

*Ivan Hajri*  
*Hajri*



DREJTORI

*Mustafë Ustina*

TURGUT ÖZAL EDU. SH.A.  
BILANCI

01.01.2016 - 31.12.2016

Kosto	AAM	Toka, troje	Ndertesa + Instal te pergjith.	Makineri e pajsje pune	Mjete transporti	lventar ekonomik	Pajsje informatike	Ne proces e pagesa plesore	Total
Gjendje më 31 dhjetor 2015		314,438,577	2,272,795,982	40,308,624	21,181,854	453,388,945	152,063,976	0	3,254,177,958
Shtesa		-	6,880,369	19,512,392	0	6,302,396	551,950	5,339,374	38,586,481
Gjendje më 31 dhjetor 2016		314,438,577	2,279,676,351	59,821,016	21,181,854	459,691,340	152,615,926	5,339,374	3,292,764,438
Zhvlerësimi i akumuluar									
Gjendje më 31 dhjetor 2015		-	498,229,701	20,568,733	-6,764,569	-244,741,683	96,014,530	-	866,319,215
Zhvlerësimi i vitit		-	88,528,204	7,159,584	-2,883,457	-42,458,568	14,053,421	-	155,083,235
Gjendje më 31 dhjetor 2016		-	586,757,905	27,728,317	-9,648,026	-287,200,251	110,067,951	-	1,021,402,450
Vlera e mbetur neto									
Gjendje më 31 dhjetor 2015		314,438,577	1,774,566,281	19,739,891	14,417,285	208,647,262	56,049,446	0	2,387,858,743
Gjendje më 31 dhjetor 2016		314,438,577	1,692,918,446	32,092,699	11,533,828	172,491,089	42,547,975	5,339,374	2,271,361,989

HARTUESI

DREJTORI








**TURGUT ÖZAL EDU. SH.A.**

**Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse**

	<b>2016</b>	<b>2015</b>
Fitimi/humbja e vitit	127,313,513	13,231,196
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin :</b>		
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		0
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje		
<b>Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesmarrjet</b>		
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		0
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	127,313,513	13,231,196
<b>Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për :</b>		
Pronarët e njësisë ekonomike mëmë	127,313,513	13,231,196
Interesat jo-kontrolluese		

HARTUESI

*Ivor Hafizi*  
*Hafizi*



DREJTORI

*Musete Cistineri*

*[Signature]*

ANEKS STATISTIKOR					
	TE ARDHURAT	Numri i Llogarise	Kodi Statistikor	Viti 2016	Viti 2015
<b>1</b>	<b>Shitjet gjithsej (a + b + c )</b>	<b>70</b>	<b>11100</b>	<b>1,461,298</b>	<b>1,361,481</b>
a)	Te ardhura nga shitja e Produktit te vet		11101		
b)	Te ardhura nga shitja e Shërbimeve		11102	1,461,298	1,361,481
c)	te ardhura nga shitja e Mallrave		11103	0	0
<b>2</b>	<b>Të ardhura nga shitje të tjera (a+b+c)</b>		<b>11104</b>	<b>201,813</b>	<b>103,611</b>
a)	Qeraja		111041	947	1,142
b)	Konvikti		111042	11,519	7,786
c)	Transport		111043	93,423	94,683
d)	Uniforme		111044	39,258	0
e)	Libra		111045	56,665	0
<b>3</b>	<b>Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshëm e prodhimeve në proçes :</b>	<b>71</b>	<b>11201</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Shtesat (+)		112011	0	0
	Pakesimet (-)		112012	0	0
<b>4</b>	<b>Prodhimi per qellimet e vet ndermarrjes dhe per kapital :</b>	<b>72</b>	<b>11300</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	nga i cili: Prodhim i aktiveve afatgjata		11301		
<b>5</b>	<b>Të ardhura nga grantet (Subvencione)</b>	<b>73</b>	<b>11400</b>	<b>61</b>	<b>70</b>
<b>6</b>	<b>Të tjera</b>	<b>75</b>	<b>11500</b>	<b>6,509</b>	<b>497</b>
<b>7</b>	<b>Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata</b>	<b>77</b>	<b>11600</b>		
<b>I)</b>	<b>Totali i te ardhurave I= (1+2+/-3+4+5+6+7+8)</b>		<b>11800</b>	<b>1,669,682</b>	<b>1,465,659</b>

HARTUESI

DREJTORI

Iva Hafizi



Mustafa Ustohar



	Aktiviteti	Te ardhurat nga aktiviteti
1	Tregti	Tregti karburanti
2	Tregti	Tregti ushqimore,pije
3	Tregti	Tregti materiale ndertimi
4	Tregti	Tregti cigaresh
5	Tregti	Tregti artikuj industrial
6	Tregti	Farmaci
7	Tregti	Eksport mallrash
8	Tregti	Tregti te tjera
<b>I</b>	<b>Totali i te ardhurave nga tregtia</b>	
9	Ndertim	Ndertim banese
10	Ndertim	Ndertim pune publike
11	Ndertim	Ndertime te tjera
<b>II</b>	<b>Totali i te ardhurave nga ndertimi</b>	
12	Prodhim	Eksport, prodhime te ndryshme
13	Prodhim	Fason te cdo lloji
14	Prodhim	Prodhim materiale ndertimi
15	Prodhim	Prodhim ushqimore
16	Prodhim	Prodhim pije alkolike, etj
17	Prodhim	Prodhime energji
18	Prodhim	Prodhim hidrokarbure,
19	Prodhim	Prodhime te tjera
<b>III</b>	<b>Totali i te ardhurave nga prodhimi</b>	
20	Transport	Transport mallrash
21	Transport	Transport malli nderkombetare
22	Transport	Transport udhetaresh
23	Transport	Transport udhetaresh nderkombetare
<b>IV</b>	<b>Totali i te ardhurave nga transporti</b>	
24	Sherbimi	Sherbime financiare
25	Sherbimi	Siguracione
26	Sherbimi	Sherbime mjekesore
27	Sherbimi	Bar restorante
28	Sherbimi	Hoteleri
29	Sherbimi	Lojra Fati
30	Sherbimi	Veprimtari televizive
31	Sherbimi	Telekomunikacion
32	Sherbimi	Eksport sherbimish te ndryshme
33	Sherbimi	Profesione te lira
34	Sherbimi	Sherbime te tjera ARSIM
<b>V</b>	<b>Totali i te ardhurave nga sherbimet</b>	1,669,681,400
	<b>TOALI (I+II+III+IV+V)</b>	<b>1,669,681,400</b>

Te punesuar mesatarisht per vitin 2016:	Nr. I te punesuarve
Me page deri ne 22.000 leke	19
Me page nga 22.001 deri ne 30.000 leke	97
Me page nga 30.001 deri ne 66.500 leke	346
Me page nga 66.501 deri ne 97.030 leke	53
Me page me te larte se 97.030 leke	136
<b>Totali</b>	<b>651</b>

HARTUESI

Ivan Hafiz  
Hafiz



DREJTORI

Mustafa Ustiner

Inventari i mjeteve te transportit ne pronesi

NR	Lloji i automjetetit	Marka	Tipi	Model	Nr Shasie	Kapaciteti	Targa	Ngjyra	Viti I Prodhimit
1	Furgon Trasporter	Mercedes - Benz	905 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S351051	22 vendesh	TR5601R	E verdhe	2008
2	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	906 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S348289	22 vendesh	TR5602R	E verdhe	2008
3	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	907 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S349838	22 vendesh	TR5603R	E verdhe	2008
4	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	908 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S349244	22 vendesh	TR5604R	E verdhe	2008
5	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	909 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S348604	22 vendesh	TR5605R	E verdhe	2008
6	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	910 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S349837	22 vendesh	TR5606R	E verdhe	2008
7	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	911 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S350917	22 vendesh	TR5607R	E verdhe	2008
8	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	912 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S352485	22 vendesh	TR5608R	E verdhe	2008
9	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	913 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S349245	22 vendesh	TR5609R	E verdhe	2008
10	Furgon Trasporter	Mercedes -Benz	914 515	Sprinter 515 CDI	WDB9066551S352486	22 vendesh	TR5610R	E verdhe	2008
11	Autoveture	Mercedes -Benz		Daimler Crysler	WDB2110061A046901	5 vendesh	AA676JD	Gri	2002

HARTUESI

*Juan Haxhizi*



DREJTORI

*Mustafë Xhironer*



**“TURGUT ÖZAL EDUCATION” SH.A.**

**Pasqyrat Financiare më dhe për  
vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**



## PËRMBAJTJA

## FAQE

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN, NETO	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7 – 23





**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.****Pasqyra e fitim humbjes dhe e te ardhurave gjithëpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)*

	Shenime	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
<b>Aktivitet</b>			
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive materiale afat-gjata	4	2,271,361,991	2,387,858,745
Aktive jo material afat-gjata	5	4,838,267	5,692,079
Fitim i shtyre nga rivleresimi		-	62,919,414
<b>Totali i Aktiveve afatgjata</b>		<b>2,276,200,258</b>	<b>2,456,470,238</b>
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Inventar	6	13,405,028	13,143,385
Llogari te arkëtueshme	7	67,281,595	58,347,076
Te arkëtueshme ndaj shtetit	22	16,470,974	31,461,654
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	8	23,121,426	52,730,385
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>120,279,024</b>	<b>155,682,500</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>2,396,479,282</b>	<b>2,612,152,738</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali aksionar	9	1,133,700,000	1,133,700,000
Rezerva të tjera	9	52,664,836	52,003,276
Fitime të pashpërndara	9	127,313,513	13,231,196
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1,313,678,349</b>	<b>1,198,934,472</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		-	-
Hua afatgjatë	10	796,196,424	803,893,776
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>796,196,424</b>	<b>803,893,776</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtër	10	145,456,028	331,359,447
Llogari të pagueshme	11	76,474,285	82,184,641
Të pagueshme të tjera	12	64,674,195	195,780,403
		<b>286,604,508</b>	<b>609,324,490</b>
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>2,396,479,282</b>	<b>2,612,152,738</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>2,396,479,282</b>	<b>2,612,152,738</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 7 deri më 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.****Pasqyra e fitim humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Të ardhura</b>			
Të ardhurat	13	1,461,298,271	1,361,480,964
Të ardhura të tjera	14	208,383,129	104,290,970
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>1,669,681,400</b>	<b>1,465,771,934</b>
<b>Shpenzime</b>			
Shpenzime për personelin	15	(611,119,547)	(551,209,703)
Materiale te konsumuara	16	(346,466,111)	(336,729,561)
Shpenzime karburanti dhe transporti	17	(81,564,049)	(84,460,742)
Shpenzime qiraje		(83,272,791)	(70,775,930)
Shpenzime shitjeje dhe marketing	18	(16,351,059)	(21,920,137)
Shpenzime për palë të treta		(27,827,927)	(22,255,513)
Shpenzime sigurie		(23,041,972)	(20,128,511)
Zhvlerësim dhe amortizim		(155,937,046)	(164,484,112)
Kostot e financës	19	(56,337,043)	(61,302,111)
Humbje nga kembimi I valutës së huaj	20	(52,243,218)	(74,318,498)
Shpenzime të tjera	21	(65,261,010)	(41,476,707)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(1,519,421,775)</b>	<b>(1,449,061,525)</b>
<b>Fitim para tatimit</b>		<b>150,259,625</b>	<b>16,710,409</b>
Shpenzimet e tatim fitimit	22	(22,946,113)	(3,479,213)
<b>FITIME PER VITIN</b>		<b>127,313,513</b>	<b>13,231,196</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pas shpenzimeve të tatimeve mbi të ardhurat</b>		-	-
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pas shpenzimeve të tatimeve mbi të ardhurat</b>		-	-
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN</b>		<b>127,313,513</b>	<b>13,231,196</b>

Pasqyra e fitim dhe humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faja 7 deri më 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.





**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**  
**Shënime e Nukseve të mjeleve monetare**

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2015</b>	1,133,700,000	43,159,717	173,796,905	1,350,656,622
Fitimi i vitit	-	-	13,231,196	13,231,196
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	<b>13,231,196</b>	<b>13,231,196</b>
Transferimi I fitimit të pashpërndarë në rezerva të tjera	-	8,843,559	(8,843,559)	-
Shpërndarja e dividendit	-	-	(164,953,346)	(164,953,346)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,133,700,000</b>	<b>52,003,276</b>	<b>13,231,196</b>	<b>1,198,934,472</b>
Fitimi I vitit	-	-	127,313,513	127,313,513
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	<b>127,313,513</b>	<b>127,313,513</b>
Transferimi I fitimit të pashpërndarë në rezerva të tjera	-	661,561	(661,561)	-
Dividend I deklaruar	-	-	(12,569,635)	(12,569,635)
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,133,700,000</b>	<b>52,664,837</b>	<b>127,313,513</b>	<b>1,313,678,349</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 7 deri më 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në 20 Mars 2017 dhe janë firmosur nga:

Iva Hafizi

Ekonomiste e Shoqërisë



Mustafa Üstuner

Administrator i Përgjithshëm




**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**  
**Shënime e flukseve të mjeteve monetare**

(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
Fitimi para tatimit	150,259,625	16,710,409
<b>Rregullime për:</b>		
Shpenzime amortizimi	155,937,046	164,484,112
Shpenzime interesi	52,683,104	60,089,718
Humbja e porealizuar nga kursi i këmbimit	62,919,414	75,076,374
<b>Fitimi në aktivitetin operativ përpara ndryshimeve në kapitalin punues:</b>	<b>421,799,190</b>	<b>316,360,613</b>
Rritje ne llogaritë e arkëtueshme	(8,934,520)	(44,048,483)
Fitim/ (humbje) ne inventar	(261,643)	(3,631,043)
Rritje ne llogaritë e pagueshme	(5,710,355)	25,886,683
Rritje e detyrimeve të tjera	(131,106,208)	179,852,167
Interesi i paguar	(52,683,104)	(60,089,718)
Tatimi i paguar mbi të ardhurat	(7,955,433)	(20,501,102)
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto e përdorur gjatë veprimtarisë së shfrytëzimit</b>	<b>215,147,926</b>	<b>393,829,117</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimit</b>		
Blerje të aktiveve fikse material	(38,586,481)	(76,047,215)
Shitje të aktiveve fikse material	-	-
Blerje të aktiveve jomateriale	-	-
Shitje të aktiveve jomateriale	-	-
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto e përdorur në veprimtaritë e investimit</b>	<b>(38,586,481)</b>	<b>(76,047,215)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet financiare</b>		
Rrënie e kredive afatgjata	(193,600,771)	(151,699,386)
Dividend I deklaruar	(12,569,635)	(164,953,346)
<b>Mjetet monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financiare</b>	<b>(206,170,406)</b>	<b>(316,652,732)</b>
<b>Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre</b>	<b>(29,608,960)</b>	<b>1,129,170</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të periudhës</b>	<b>52,730,385</b>	<b>51,601,215</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	<b>23,121,425</b>	<b>52,730,385</b>

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 7 deri më 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare





## **TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)*

### **1. Informacion i përgjithshëm**

Turgut Özal Education Sh.a. (në vijim referuar si "Shoqëria") është një institucion arsimor që operon në Shqipëri, e themeluar më 21 Shtator 2001 si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "UFUK, Education & Publication Company", e cila është ndryshuar më vonë në "Turgut Ozal Education". Më 01.01.2008 Shoqëria ka ndryshuar formën e saj juridike në një Shoqëri aksionare.

Përfaqësuesi ligjor i kompanisë është Z. Mustafa Üstuner.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është të përmbushë standartet dhe të ndjekë programet e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit pa ndonjë diskriminim politik, fetar, racor dhe gjinor. Institucioni ofron një formim akademik të një niveli të lartë si një përgjigje ndaj kërkesës së studentëve dhe përgatitjen për një karrierë të suksesshme.

Kapitali i Shoqërisë është 1,133,700,000 Lek i ndarë në mënyrë të barabartë në 1,133,700 aksione me një vlerë nominale prej 1,000 Lek për aksion.

Adresa e Shoqërisë është Rr. "Pavarësia", Aut. Tiranë - Durrës Km.1 / Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2016, numri i punonjësve të Shoqërisë ka qënë 651 punonjës.

### **2. Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), mbi bazën e kostos historike. Pasqyrat Financiare të Shoqërisë janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, sipas së cilës Shoqëria do të vazhdojë të operojë dhe në periudhën raportuese në vijim.

Përgatitja e pasqyrave financiare është në përputhje me kërkesat e SNRF-ve për përdorimin e vlerësimeve dhe supozimeve nga manaxhimi. Bordi Mbikëqyrës përdor gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël të kompanisë.

### **3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**

#### **3.1 Prezantimi i pasqyrave financiare**

Pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike

#### **3.2 Transaksionet në monedhë të huaj**

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në LEK, që është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e raportimit. Asetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj janë të matura me koston historike dhe konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet ose humbjet e rezultuara nga këto transaksione njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.





### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### 3.2 Njohja e të ardhurave

##### i. Të ardhura nga shitja e mallrave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë nga Shoqëria. Të ardhurat njihen kur kemi prova për ekzistencën e tyre, zakonisht në formën e mallrave të dhëna ose shërbimeve të kryera ku rreziqet dhe përfitimet e lidhura me to janë transferuar nga shitësi tek blerësi; mbledhja e të cilave është e mundshme; kostot e lidhura me to dhe kthimet e mundshme të produkteve dhe shërbimeve mund të maten në mënyrë të besueshme; nuk ka përfshirje të vazhdueshme të manaxhimit në produktet dhe shërbimet dhe nëse shuma e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Koha e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve varet nga kushte specifike gjatë procesit të shitjes.

##### ii. Shërbimet

E ardhura nga shitja e shërbimeve njihet në pasqyrat financiare të fitimit ose humbjes duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

##### iii. Të ardhura nga interesi

E ardhura nga interesi përfaqësohet nga interesi mbi fondet e investuara në depozita dhe njihet në fitim ose humbje në bazë të parimit të kontabilitetit rritës duke përdorur metodën e interesi efektiv.

#### 3.3 Aktive afatgjata materiale

Zëri i aktiveve afatgjata materiale është e matur me kosto historike duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto historike përfshin shpenzimet e lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Shpenzimet shtesë do të kapitalizohen në qoftë se nga përdorimi i tyre do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen dhe nëse shuma e tyre mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera të mirëmbajtjes dhe riparimit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në kohën kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Amortizimi fillon kur aktivi është në dispozicion për përdorim. Normat e amortizimit janë si më poshtë:

Kategoritë e aktiveve	Metoda	Përqindja / vit
Ndërtesa	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	2.5%-5%
Pajisje zyre	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Makina	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%
Pajisje kompjuterike	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	25%
Të tjera	Zhvlerësim mbi vlerën e mbetur	20%

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabël neto do të ulet deri në vlerën e rikuperueshme nëse ajo tejkalon vlerën e mbetur të aktivitetit. Fitimi ose humbja neto që rrjedh nga shitja e një aktivi afatgjatë material njihet në zërin "Të ardhura të tjera operative" në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

#### 3.4 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jo materiale të blera nga Shoqëria të cilat kanë një jetë të dobishme të përcaktuar, janë të praqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.





### **3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### *Kosto shtesë*

Kostot shtesë do të kapitalizohen në qoftë se nga përdorimi i tyre do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera, përfshirë shpenzime për emrin e mirë dhe markave të prodhuara do të njihen në pasqyrën e të ardhurave, kur ato ndodhin. Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e softëare-ve kompjuterike njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

#### *Amortizimi*

Amortizimi llogaritet duke përdorur amortizimin linear mbi jetën e dobishme të aktivitetit jo material që nga data e vënies në përdorim. Kostot e softëare-ve të njohura si aktiv do të amortizohen mbi vlerësimin e jetës së dobishme, e cila nuk është më shumë se 4 vjet. Jeta e dobishme rishikohet dhe rregullohet nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një aktiviteti jo-material maten si diferencë midis të ardhurës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël neto të aktivitetit dhe njihen si fitime ose humbje.

Për të vlerësuar humbjen, Shoqëria përcakton grupin më të vogël të aktiveve të cilat gjenerojnë flukse të identifikueshme të mjeteve monetare (njësia gjeneruese e mjeteve monetare). Si rezultat, disa aktive vlerësohen për humbjen individualisht dhe disa të tjera përfshihen në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare.

#### **3.5 Qira operative**

Pagesat e bëra për qiranë operative njihen dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve mbi një bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë. Skontot e marra nga qiradhënësi do të njihen si pjesë e pagesës totale të qirasë sipas termave të qirasë.

#### **3.6 Inventari**

Inventari matet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes dhe kostot e tjera të ndodhura gjatë sjelljes së inventarit në vendodhjen dhe gjendjen aktuale, duke përfshirë dhe koston e vulës së blerë nga Drejtoria e Doganave të Republikës së Shqipërisë lidhur me akcizën e produktit. Vlera neto e realizueshme është vlerësuar me çmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus kostot e përfundimit dhe shpenzimeve të shitjes.

#### **3.7 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në arkë dhe llogari rrjedhëse të mbajtura me kosto. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **3.8 Aktivet financiare**

Instrumentat financiarë të Shoqërisë gjatë 2016 përbëhen vetëm nga instrumenta financiarë joderivative: hua dhe të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre (ku përfshihen depozitat bankare të mbajtura deri në maturim) dhe të pagueshme të tjera. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë ose me koston e amortizuar, sipas klasifikimit të tyre.

#### *Njohja*

Shoqëria fillimisht njihet të arkëtueshmet financiare, depozitat dhe llogaritë e investimeve në datën në të cilën janë krijuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

#### *Matja e mëvonshme*

Të gjitha aktivet financiare do të jenë subjekt i rivlerësimeve pas njohjes së tyre në kontabilitet, të cilat do të maten me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë. Një matje e tillë është e zbatueshme për të gjitha aktivet dhe/ose detyrimet financiare. Në mënyrë të veçantë, për investimet e borxhit që i përkasin një modeli biznesi,





### **3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **3.9 Aktivet financiare (vazhdimi)**

objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale të përbëra nga pagesa për principalin dhe interesin janë përgjithësisht të matura me koston e amortizuar në fund të periudhave raportuese. Instrumentat e borxhit që i përkasin një modeli biznesi objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare dhe shitja e aktiveve financiare, janë të matur në përgjithësi në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse.

#### ***Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj***

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në arkë dhe llogari rrjedhëse të mbajtura me kosto. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### ***Llogari të arkëtueshme***

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbje nga rënia në vlerë. Llogaritë e arkëtueshme aftashkurtra nuk skontojnë.

#### ***Huatë dhe llogari të pagueshme të tjera***

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen me vlerën e tyre të amortizuar.

#### ***(i) Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare***

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ekziston një tregues objektiv që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të aktivit. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi bazë individuale. Aktivet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

#### ***(ii) Çregjistrimi***

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose kur transferon aktivitetin financiar në një transaksion në të cilën kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar transferohen. Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ose janë anuluar.

#### ***(iii) Kompensimi i instrumentave financiarë***

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen në shumën neto që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur, Shoqëria ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe nuk synon të vendosë mbi shlyerjen mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivitetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

#### ***(iv) Vlera e drejtë***

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të arkëtueshme tregëtare dhe të tjera, të pagueshme tregëtare dhe të tjera janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël për shkak të termave të shkurtër të maturitetit.





### **3.10 Kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme**

Një plan me kontribute të përcaktuara është një skemë përfitimi pas-punësimit, në të cilën Shoqëria paguan kontribute fikse në një entitet të veçantë, pa ndonjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar shuma shtesë. Detyrimet për kontributet për skemat pensionale, me një fond të përcaktuar kontributësh, si ajo e qeverisë Shqiptare janë njohur në pasqyrën e fitim ose humbjes kur detyrimi duhet të paguhet.

### **3.11 Përfitimet afatshkurtra**

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve janë llogaritur mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime kur shërbimi është kryer. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet nga përfitimet afatshkurtra, nëse Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të ofruara nga punonjësit dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

### **3.12 Përfitimet e punonjësve**

Në përputhje me kushtet e Kodit të Punës, kompanitë shqiptare janë të detyruara të paguajnë kontribute mujore për përfitime të daljes në pension të parashikuara për punonjësit e tyre të administruara nga skema me kontribute të përcaktuara të shtetit. Shoqëria nuk ka detyrime shtesë për punonjësit që largohen nga kompania apo të drejtën për kontributet pensionale.

### **3.13 Tatimi mbi të ardhurat**

#### **Tatimi mbi të ardhurat i parapaguar**

Aktivitet dhe detyrimet e të ardhurave të parapaguara për periudhën aktuale dhe të mëparshme maten me shumën që pritet të rikthehet ose të paguhet në organet tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore nga ku shuma e tatimit janë llogaritur janë ato që janë miratuar në datën e raportimit.

#### **Tatimi mbi të ardhurat e shtyra**

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, sipas ligjeve në fuqi. Një aktiv ose detyrim tatimor i shtyrë njihet nëse ekziston një e drejtë ligjore për kompensim në lidhje me tatimin mbi të ardhurat e parapaguara të mbledhura nga i njëjti autoritet.

### **3.14 Provigjonet, pasivet dhe aktivet**

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të kaluara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet me besueshmëri dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të detyrimin.

### **3.15 Pasqyrat financiare krahasuese**

Disa zëra të pasqyrave financiare bashkëlidhur janë riklasifikuar për të dhënë një pamje më të mirë të llogarive.

### **3.16 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.



### **3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse në pasqyrat financiare. Përdorimi i vlerësimit kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale duke marrë parasysh thjeshtësinë e natyrës së operacioneve që Shoqëria kryen.

#### **Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare të kompanisë janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, e cila supozon se Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj operacional në të ardhmen e parashikueshme. Në bazë të planit të miratuar financiar të kompanisë në vitet e ardhshme, Shoqëria parashikon të rrisë aktivitetin e saj operacional dhe gjithashtu është parashikuar një rezultat pozitiv në vitin e ardhshëm. Përveç sa më sipër, aksionarët e kompanisë janë të angazhuar për të mbështetur financiarisht Shoqërinë në rast se do të jetë e nevojshme.





**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**4. Aktive afatgjata materiale**

Aktivët afatgjata materiale për 31 dhjetor 2016 janë të përbëra si më poshtë:

Kosto	Tokë	Ndërtesë	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje zyre	Pajisje kompjuterike	Ne proces e pagesa pjesore	Totali
Gjendje më 31 dhjetor 2015	314,438,577	2,272,795,982	40,308,624	21,181,854	453,388,945	152,063,976	-	3,254,177,958
Shtesa	-	6,880,369	19,512,392	-	6,302,396	551,950	5,339,374	38,586,481
Gjendje më 31 dhjetor 2016	314,438,577	2,279,676,351	59,821,016	21,181,854	459,691,340	152,615,926	5,339,374	3,292,764,438
Zhvlerësimi i akumuluar								
Gjendje më 31 dhjetor 2015	-	(498,229,701)	(20,568,733)	(6,764,569)	(244,741,683)	(96,014,530)	-	(866,319,215)
Zhvlerësimi i vitit	-	(88,528,204)	(7,159,584)	(2,883,457)	(42,458,568)	(14,053,421)	-	(155,083,235)
Gjendje më 31 dhjetor 2016	-	(586,757,905)	(27,728,317)	(9,648,026)	(287,200,251)	(110,067,951)	-	(1,021,402,450)
Vlera e mbetur neto								
Gjendje më 31 dhjetor 2015	314,438,577	1,774,566,281	19,739,891	14,417,285	208,647,262	56,049,446	-	2,387,858,743
Gjendje më 31 dhjetor 2016	314,438,577	1,692,918,446	32,092,699	11,533,828	172,491,089	42,547,975	5,339,374	2,271,361,989



**TURGUT ÖZAL EDUCATION S.H.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**4. Aktive afatgjata material (vazhdim)**

Aktivët afatgjata materiale për 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë të përbëra si më poshtë:

Kosto	Tokë	Ndërtesë	Makinëri		Mjete		Në proces		Pajisje		Totali
			dhe pajisje	Transporti	Pajisje zyre	pagesa pjesore	kompiuterike				
Gjendje më 31 dhjetor 2014	314,438,577	2,241,771,676	35,738,765	21,181,854	418,822,092	-	147,073,779	3,179,026,743			
Shtesa	-	31,024,306	4,569,859	-	34,566,853	-	4,990,197	75,151,215			
Gjendje më 31 dhjetor 2015	314,438,577	2,272,795,982	40,308,624	21,181,854	453,388,945	-	152,063,976	3,254,177,958			
Zhvlerësimi i akumuluar											
Gjendje më 31 dhjetor 2014	-	(406,166,202)	(16,246,395)	(3,160,247)	(198,808,225)	-	(78,432,166)	(702,813,235)			
Zhvlerësimi i vitit	-	(92,063,500)	(4,322,338)	(3,604,321)	(45,933,458)	-	(17,582,364)	(163,505,981)			
Gjendje më 31 dhjetor 2015	-	(498,229,701)	(20,568,733)	(6,764,569)	(244,741,683)	-	(96,014,530)	(866,319,216)			
Vlera e mbetur neto											
Gjendje më 31 dhjetor 2014	314,438,577	1,835,605,474	19,492,370	18,021,607	220,013,867	-	68,641,613	2,476,213,508			
Gjendje më 31 dhjetor 2015	314,438,577	1,774,566,281	19,739,891	14,417,285	208,647,262	-	56,049,446	2,387,858,742			





**5. Aktive afatgjata jomateriale**

Aktivët afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë të perbera si më poshtë:

	Aktive të tjera jomateriale	Totali
<b>Kosto</b>		
Gjendje më 31 dhjetor 2015	11,741,850	11,741,850
Shtesa	-	-
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2016</b>	<b>11,741,850</b>	<b>11,741,850</b>
<b>Zhvlrësimi i akumuluar</b>		
Gjendje më 31 dhjetor 2015	(6,049,770)	(6,049,770)
Zhvlrësimi i vitit	(853,812)	(853,812)
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(6,903,582)</b>	<b>6,903,582</b>
<b>Vlera e mbetur neto</b>		
Gjendje më 31 dhjetor 2015	5,692,080	5,692,080
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2016</b>	<b>4,838,268</b>	<b>4,838,268</b>

Aktivët afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë të perbera si më poshtë:

	Aktive të tjera jomateriale	Totali
<b>Kosto</b>		
Gjendje më 31 dhjetor 2014	10,845,850	10,845,850
Shtesa	896,000	896,000
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2015</b>	<b>11,741,850</b>	<b>11,741,850</b>
<b>Zhvlrësimi i akumuluar</b>		
Gjendje më 31 dhjetor 2014	(5,071,638)	(5,071,638)
Zhvlrësimi i vitit	(978,132)	(978,132)
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(6,049,770)</b>	<b>(6,049,770)</b>
<b>Vlera e mbetur neto</b>		
Gjendje më 31 dhjetor 2014	5,774,212	5,774,212
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2015</b>	<b>5,692,080</b>	<b>5,692,080</b>



**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***6. Inventari i imet**

Inventari i imet më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhet nga:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Inventari I imet	26,810,058	26,286,772
Zhvlerësimi i inventarit	(13,405,030)	(13,143,387)
<b>Totali</b>	<b>13,405,028</b>	<b>13,143,385</b>

Lëvizjet për zhvlerësimin e inventarit janë paraqitur si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Balanca hapëse	13,143,385	9,512,343
Zhvlerësimi	261,643	3,631,042
Rimarrja e zhvlerësimit	-	-
<b>Balanca mbyllëse</b>	<b>13,405,028</b>	<b>13,143,385</b>

**7. Llogari te arketueshme dhe te tjera**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Parapagime	67,127,595	54,891,770
Llogari të arkëtueshme	154,000	3,455,306
<b>Totali</b>	<b>67,281,595</b>	<b>58,347,076</b>

**8. Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Paraja në arkë	505,021	661,522
Paraja më Bankë	22,616,404	52,068,863
<b>Totali</b>	<b>23,121,426</b>	<b>52,730,385</b>





**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***9. Kapitali i Aksionarëve**

Tabela më poshtë tregon strukturën e kapitalit të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	Numri i aksioneve 2016	Aksione në %	Numri i aksioneve 2015	Aksione në %
Aksionarët				
Davut Hancioglu	226,740,000	20 %	113,370,000	10 %
Yakup Arslan	340,110,000	30 %	-	-
Adnan Hosoglu	340,110,000	30 %	340,110,000	30 %
Rahmi Tozduman	226,740,000	20 %	226,740,000	20 %
Avni Ertansel	-	-	226,740,000	20 %
Sadik Sadikoglu	-	-	113,370,000	10 %
Abdulkadir Kazaca	-	-	113,370,000	10 %
<b>Totali</b>	<b>1,133,700,000</b>	<b>100 %</b>	<b>1,133,700,000</b>	<b>100 %</b>

Më 31 dhjetor 2016, kapitali i nënshkruar dhe i paguar përbëhet nga 1,133,700 aksione me vlerë nominale prej 1,000 LEK (2015: 1,133,700 aksione me vlerë nominale prej 1,000 LEK)

**10. Hua afatgjata**

Huat afatgjata më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë përbere si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Pjesë e huave afatgjata	796,196,424	803,893,776
Interes i përlloritur	-	-
<b>Totali</b>	<b>796,196,424</b>	<b>803,893,776</b>
Pjesë e huave afatshkurtra	145,456,028	331,359,447
Interes i përlloritur	-	-
<b>Totali</b>	<b>145,456,028</b>	<b>331,359,447</b>

**11. Llogari te pagueshme tregetare**

Llogaritë e pagueshme më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Të pagueshme ndaj palëve të treta	76,474,285	82,184,641
<b>Totali</b>	<b>76,474,285</b>	<b>82,184,641</b>



**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***12. Detyrime të tjera**

Detyrimet e tjera më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Të pagueshme ndaj personelit	39,810,348	40,141,406
Kontribute shoqërore shëndetësore	7,944,870	10,039,045
Tatimi mbi të ardhurat personale	4,267,011	4,225,078
Tatim në burim	-	199,500
Tatime të tjera te pagueshme	826,708	51,031
TVSH e pagueshme	1,073,227	132,348
Detyrime të tjera	53,000	781,652
Dividend per tu paguar	10,699,031,	140,210,344
<b>Totali</b>	<b>64,674,195</b>	<b>195,780,403</b>

**13. Të ardhurat**

Të ardhurat më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Të ardhura nga shkollimi	(1,461,298,271)	(1,361,480,964)
<b>Totali</b>	<b>(1,461,298,271)</b>	<b>(1,361,480,964)</b>

**14. Të ardhura të tjera**

Të ardhurat e tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Të ardhura nga uniformat	39,258,456	-
Të ardhura nga librat	56,665,139	-
Të ardhura nga transporti	93,423,468	94,683,317
Të ardhura nga akomodimi	11,519,424	7,786,256
Të ardhura nga shërbime të tjera	7,516,643	1,821,398
<b>Totali</b>	<b>208,383,129</b>	<b>104,290,970</b>

**15. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit përbëhen nga paga dhe kontributet të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore:

	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzimet e pagës	539,915,221	483,507,394
Shpenzimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	70,886,326	67,377,309
Shpenzime të tjera personeli	318,000	325,000
<b>Totali</b>	<b>611,119,547</b>	<b>551,209,703</b>





**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***16. Materiale konsumi**

Materiale konsumi më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015</b>	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzime ushqimi	180,605,872	170,792,268
Shpenzime utilitare	41,626,449	37,454,186
Shpenzime sanitare	10,222,155	11,279,287
Libra dhe materiale të tjera shkollore	41,865,012	63,986,745
Shpenzime kancelarike	16,833,353	21,200,638
Uniformat	55,313,270	32,016,437
<b>Totali</b>	<b>346,466,111</b>	<b>336,729,561</b>

**17. Shpenzime karburanti dhe transporti**

Shpenzime karburanti dhe transporti më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzime karburanti	17,935,057	22,480,373
Shpenzime transporti	63,628,992	61,980,370
<b>Totali</b>	<b>81,564,049</b>	<b>84,460,742</b>

**18. Shpenzime shitje dhe marketingu**

Shpenzime shitje dhe marketingu më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzim reklame	5,151,000	8,638,270
Shpenzime për dieta dhe udhëtime	5,922,224	8,853,299
Shpenzime përfaqësimi	818,025	295,150
Shpenzime poste dhe komunikimi	4,459,810	4,133,418
<b>Totali</b>	<b>16,351,059</b>	<b>21,920,137</b>

**19. Kosto financiare**

Kostot financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015</b>
Komisione Bankare	3,653,939	1,238,168
Shpenzime interesi	52,683,104	60,089,718
Të ardhura nga interesi	-	(25,775)
<b>Totali</b>	<b>56,337,043</b>	<b>61,302,111</b>



**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***20. Fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit**

Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015</b>
Humbja nga kursi i këmbimit	52,243,218	74,318,498
Fitimi nga kursi i këmbimit	-	(0)
<b>Totali</b>	<b>52,243,218</b>	<b>74,318,498</b>

**21. Shpenzime të tjera**

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzime nga tatimi	26,344,628	14,433,814
Shpenzime mirëmbajtjeje	20,684,597	10,577,744
Shpenzime sigurimi	914,856	1,351,529
Shpenzime të tjera	17,316,929	15,113,620
<b>Totali</b>	<b>65,261,010</b>	<b>41,476,707</b>

**22. Shpenzimet e tatim fitimit**

Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen nga:

	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzimet e vitit e tatimeve mbi të ardhurat	22,946,113	3,479,213
<b>Totali</b>	<b>22,946,113</b>	<b>3,479,213</b>





**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***22. Shpenzimet e tatim fitimit**

Tatimi mbi të ardhurat përbëhet nga tatimi mbi të ardhurat për vitin financiar 2016. Në përputhje me rregulloren tatimore Shqiptare, norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2016 është 15% (2015: 15%)

	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>150,259,625</b>	<b>16,710,409</b>
<b>Shpenzime të pazbritshme :</b>		
Rimarrje e zhvlerësimeve të inventarit	-	-
Rimarrje e zhvlerësimit të llogarisë së pambledhshme	170,316	-
Shpenzimi i llogaritur	-	-
Zhvlerësim i inventarit	-	-
Shpenzime të tjera të pazbritshme	2,544,144	6,484,345
<b>Totali i shpenzimeve të pazbritshme</b>	<b>2,714,460</b>	<b>6,484,345</b>
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>152,974,085</b>	<b>23,194,754</b>
Shpenzimi tatimor i vitit	22,946,113	3,479,213
<b>Përqindja efektive e tatim mbi fitimin</b>	<b>15%</b>	<b>21%</b>

Kthimet tatimore paraqiten çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore mbetet e përkohshme deri sa autoritetet tatimore të shqyrtojë raportet dhe të dhënat e tatimpaguesit dhe të bejnë një vlerësim përfundimtar. Ligjet tatimore shqiptare dhe rregulloret janë subjekt i interpretimeve nga organet tatimore.

**23. Palët e lidhura**

Në rrjedhën e kryerjes së veprimtarisë operacionale, Shoqëria ka hyrë në transaksione të ndryshme me palët e lidhura.

Për periudhën e mbyllur 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015, kanë ndodhur transaksionet me palët e lidhura si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015
Të pagueshme ndaj ortakeve	(10,699,031)	(140,210,344)
Të arketueshmë nga palët e lidhura	-	-
<b>Totali</b>	<b>(10,699,031)</b>	<b>(140,210,344)</b>



**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)***24. Angazhime dhe garanci**

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, Shoqëria mund të jetë e përfshirë në pretendime ligjor ose veprime të palëve të treta. Në bazë të mendimit të shoqërisë në lidhje me këto çështje, është se nuk do të ketë një efekt mbi pozicionin financiar të kompanisë, ose nuk do të sjellë ndryshime në aktive.

**25. Menaxhimi financiar i riskut**

Menaxhimi i rrezikut është një element thelbësor në aktivitetet e kompanisë. Rreziqet më të mëdha me të cilat kompania përballet janë ato që lidhen me rrezikun e tregut (duke përfshirë çmimin, normën e interesit dhe rrezikun e këmbimit valutor), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit.

*(i) Rreziku i kursit të këmbimit*

Kompania mban aktivet dhe detyrimet të shprehura në euro. Rreziku i kursit të këmbimit është i pranishëm kur aktivet aktuale ose të parashikuara në monedhë të huaj janë më pak ose më shumë se detyrimet në këtë monedhë. Ndikimi i rrezikut të kursit të këmbimit të kompanisë është i kufizuar pasi transaksionet në monedhat në lekë dhe në euro janë të kufizuara..

Ekspozimi i Shoqërisë me kursin e këmbimit në 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Më 31 Dhjetor 2016	Vlera kontabël (neto)	Euro	USD	Lek
Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj	23,121,426	11,564,388	651,746	10,905,292
Llogari të arkëtueshme tregtare	67,281,595	67,127,595	-	154,000
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>90,403,020</b>	<b>78,691,983</b>	<b>651,746</b>	<b>11,059,291</b>

Më 31 Dhjetor 2016	Vlera kontabël (neto)	Euro	USD	Lek
Llogari të pagueshme	(76,474,285)	(45,102,438)	-	(31,371,847)
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(10,699,031)	-	-	(10,699,031)
Të pagueshme të tjera	(53,975,164)	-	-	(53,975,164)
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>(141,148,480)</b>	<b>(45,102,438)</b>	<b>-</b>	<b>(96,046,042)</b>
<b>Pozicioni neto i kursit të këmbimit</b>	<b>(50,745,460)</b>	<b>33,589,545</b>	<b>651,746</b>	<b>(84,986,751)</b>

Më 31 dhjetor 2015	Vlera kontabël (neto)	Euro	USD	Lek
Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj	52,730,385	49,735,746	664	2,993,975
Llogari të arkëtueshme tregtare	58,347,076	54,891,770	-	3,455,306
Llogari të arkëtueshme ndaj palëve të treta	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>111,077,461</b>	<b>104,627,516</b>	<b>664</b>	<b>28,055,501</b>





**TURGUT ÖZAL EDUCATION SH.A.**

Shënime mbi pasqyrat financiare

*(Të gjitha shumat janë në LEK, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)*

Më 31 dhjetor 2015	Vlera kontabël			
	(neto)	Euro	USD	Lek
Llogari të pagueshme	(82,184,641)	(15,152,780)	(2,386,362)	(64,645,499)
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(140,210,344)	-	-	(140,210,344)
Të pagueshme të tjera	(55,570,059)	-	-	(55,570,059)
<b>Totali i Detyrimeve financiare</b>	<b>(277,914,013)</b>	<b>(15,152,780)</b>	<b>(2,386,362)</b>	<b>(260,374,871)</b>
<b>Pozicioni neto i kursit të këmbimit</b>	<b>(166,836,552)</b>	<b>89,474,736</b>	<b>(2,385,698)</b>	<b>(232,319,370)</b>

Më poshtë janë kurset e këmbimit të aplikuara gjatë vitit:

	Kursi i këmbimit mesatar		Kursi i këmbimit në datën raportuese	
	2016	2015	2016	2015
EUR	137.37	137.28	135.23	137.28
USD	124.14	100.00	128.17	125.79

Analiza e ndjeshmërisë për këmbimin valuator

Analiza e ndjeshmërisë është përcaktuar sipas ekspozimit që ka Shoqëria ndaj monedhave të huaja në datën e raportimit dhe ndryshimi në kurset e këmbimit në fillim të vitit financiar. Gjatë vitit raportues aplikohen kurset e këmbimit të Bankes së Shqipërisë në ditën e veprimeve. Më poshtë paraqiten efektet e ndryshimeve të kurseve të këmbimit në fitimin e vitit, duke supozuar se të gjithë faktorët e tjerë janë mbajtur konstant:

*(ii) Rreziku i normës së interesit*

Të ardhurat dhe flukset monetare të Shoqërisë janë të pavarura nga ndryshimet në normën e interesit në treg. Shoqëria nuk disponon aktive me vlerë materiale, shuma e të cilave varet nga norma e interesit.

*(iii) Rreziku nga Taksimi*

Legjislacioni tatimor shqiptar është subjekt i interpretimeve të ndryshme dhe ndryshimeve të vazhdueshme. Si rezultat, transaksionet mund të kundërshtohen nga organet tatimore dhe Shoqërisë mund t'i ngarkohen taksa shtesë, gjopa dhe interes, të cilat mund të jenë të rëndësishme. Periudhat raportuese mbeten të hapura për t'u shqyrtuar nga organet tatimore dhe doganore në lidhje me detyrimet tatimore për një periudhë pesë vjeçare. Shoqëria nuk është në dijeni të asnjë rrethane, të cilat mund të sjellin një detyrim të mundshëm material në këtë drejtim.

**26. Ngjarje pas datës së raportimit**

Nuk ka pasur asnjë ngjarje pas datës së raportimit, e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.

*Ivan Hafizi*  
Ivan Hafizi



*Mustafa Ustiner*  
Mustafa Ustiner



**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania sh.p.k  
Rr. Elbasanit.  
Pallati poshte Fakulteti  
Gjeologji- Miniera  
Tirana, Albania  
Tel: +355 4 45 17 920  
Fax: +355 4 45 17 990  
[www.deloitte.al](http://www.deloitte.al)

VAT (NUIS) No: L41709002H

**Datë:** 30 mars 2017  
**Drejtuar:** TURGUT OZAL EDUCATION  
**Subjekti:** Konfirmim i shërbimeve të auditimit

Në vijim të kërkesës suaj konfirmojmë së bazuar në kontratën e auditimit të lidhur midis Deloitte Audit Albania Sh.p.k dhe TURGUT OZAL EDUCATION me NUIS K121250040, Deloitte Audit Albania sh.p.k është në procesin e auditimit të pasqyrave financiare të TURGUT OZAL EDUCATION për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2016.

Me respekt,

*Deloitte Audit Albania sh.p.k*



Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/global/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited



**SHOQERIA :** TURGUT OZAL EDUCATION SH.A.

Datë, 20 / 03 / 2017

**NIPTI :** K 12 12 50 04 O

### DEKLARATE

Deklaroj se **Shoqëria jone** “Turgut Ozal Education” Sh.a. me **NIPT** K12125004O me Administrator te Pergjithshem Z. MUSTAFA ÜSTÜNER dhe aksionere ne daten 31.12.2016 :

1. Z. Rahmi Tozduman perqindja e pjesemarrjes 20 % , me 226.740 aksione me vlere 1.000 leke/aksion.
2. Z. Yakup Arslan perqindja e pjesemarrjes 30 % , me 340.110 aksione me vlere 1.000 leke/aksion.
3. Z. Davut Hancioğlu perqindja e pjesemarrjes 20 % , me 226.740 aksione me vlere 1.000 leke/aksion.
4. Z. Adnan Hoşoğlu perqindja e pjesemarrjes 30 % , me 340.110 aksione me vlere 1.000 leke/aksion.

ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2016 komform ligjeve ne fuqi per kontabilitetin.

Hartuesi i pasqyrave financiare eshte:

1. Znj. Iva Hafizi, ekonomiste e punësuar pranë shoqërisë.

**Administrator i Shoqërise**

MUSTAFA ÜSTÜNER

